



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



Data:	06.10.2022
PËR :	Departamenti Ligjor i MAPL-së z. Besim Murtezani
PËRMES:	Kryetari i Komunës Mehmet Ballazhi
NGA :	Shefi i Zyrës Ligjore Bajrush Laçi
LËNDA:	Lista e Vendimeve e Kryetarit të Komunës për muajin Shtator, 2022

I nderuar z. Murtezani;

Duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale me nr. 03/L-040, përkatësisht, neni 80 nënparagrafi 80.1, dërgojmë listën e vendimeve e kryetarit të Komunës siç vijnë:

1. Vendim për miratimin e buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2024-2025 të komunës Hani i Elezit, me numër 01.Nr.8289/2022;
2. Vendim për rialokim të mjeteve në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale, me numër 01.Nr.8274 /2022;
3. Vendim miratimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit, me numër 01.Nr.7650/2022;
4. Vendim për draft Rregulloren për Administrimin e Shtëpisë së Kulturës në komunën e Hanit të Elezit, me numër 01.Nr.8456/2022 dhe
5. Rregullore për Taksa Komunale për vitin 2023, me numër 01.6633/2022

Me respekt.



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 8289/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 24, 40, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr. 03/L-48 neni 20, Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-49 neni 2, Qarkoret Buxhetore 2023/01 me nr. 996/2022 dhe 2023/02 me nr. 1760/2022 për Komunat, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 29.09.2022 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2023 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITET 2024-2025 TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

1. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023 është në shumë prej 3,349,715 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2024 janë në shumë prej 3,569,968 € dhe për vitin 2025 janë në shumë prej 3,713,992 €.
2. Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin 2023 sipas pikës (1) të këtij vendimi, mjetet nga grantet qeveritare janë në shumë prej 2,789,593 €, që shënojnë pjesëmarrje prej 83.27%, ndërsa nga të hyrat vetanake komunale në shumë prej 560,121 € apo 16.72%.
3. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2023 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje buxhetore: paga dhe shtesa 1,702,823 €, mallra dhe shërbime 465,000 €, shpenzime komunale 96,500 €, subvencione dhe transfere 100,000 € dhe shpenzime kapitale 985,392 €.
4. Pjesë përbërse të këtij vendimi janë tabelat e buxhetit për vitet 2023-2025 (tabelat 4.1, 4.2 dhe 4.3).
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Data : 29.09.2022
Hani i Elezit



Kryesuesi i Kuvendit
Florina Shkreta



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 8274/2022

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 11, 12, 40, Ligjit Nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, neni 3, paragrafi 1.32, 1.43, neni 17 paragrafi 1, Ligjit Nr. 03L/-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30, paragrafi 1, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 29.09.2022 merr këtë:

VENDIM
PËR RIALOKIM TË MJETEVE NË KATEGORINË EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE
KAPITALE

1. Miratohet kërkesa me nr. **04/7847/2022** e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për rialokim të mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale.
2. Rialokimi të mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale është në shumë prej **42,695.00 €**.

Pra, rialokimi i mjeteve në total për komunën e Hanit të Elezit është në shumë prej **42,695.00 €** nga fondi 21 sipas programeve/nën-programeve buxhetore.

Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, burimi i financimit (21).
Në kuadër të nën-programit Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620).

Rialokohen nga projektet:

- “Ndërtimi i fushave sportive në fshatin Rezhancë, Lagjja Meliq dhe Lagjja e re”, kodi (51723) në shumë prej 5,000.00€;
- “Asfaltimi i rrugës Gorancë-Krivenik”, kodi (47270) shuma prej 5,000.00 €;
- “Ndërtimi i mureve mbrojtëse nëpër zonat rurale dhe urbane”, kodi (50146) shuma prej 5,000.00 €,
- “Vendosja e paisjeve digjitale E-Kioska në Han të Elezit”, kodi (51721) shuma prej 10,000.00 €,
- “Pyllëzimi i zonave të zhveshura në njësinë menaxhuese Uji i Bardhë”, kodi (51600) shuma prej 3,000.00 €,
- “Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik”, kodi (51576) shuma prej 9,695.00 €,
- “Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc”, kodi (41635) shuma prej 5,000.00 €.

Rialokohen në projektet:

- “Ndërtimi i qendrës kulturore në Han të Elezit”, kodi (48921) në shumë prej 5,000.00 €
- “Rregullimi i kanalizimeve në Han të Elezit në Rr. Isa Berisha dhe zonat rurale në fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Krivenik, Dimcë”, kodi (51581) në shumë prej 5,000.00 €;
- “Ndërtimi (rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Dermjak, Paldenicë, Pustenik, Seçishtë”, kodi (51720) në shumë prej 23,000.00 €;
- “Ndërtimi i qendrës kulturore në Han të Elezit”, kodi (48921) në shumë prej 9,695.00 €,

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë, pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive Komunale,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Data : 29.09.2022
Hani i Elezit



Kryesues i Kuvendit

Elorim Shkreta



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr.7650/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.09.2022 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2023

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës së kuvendit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023.
2. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023 planifikon t'i mbajë gjithsej dymbëdhjetë mbledhje të rregullta dhe çdo mbledhje të kuvendit i paraprin mbledhja e komitetit për politik dhe financa.
3. Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit, do të mbahen sipas periudhës kohore të paraqitura si në tabelë:

	Vendimet/Çështjet
JANAR 2023	• Raporti financiar për vitin 2022. • Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2022-2023. • Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2023. • Plani i punës së Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. • Plani i punës së Komitetit Konsultativ për zhvillim ekonomik, planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit. • Plani i punës së Komitetit Konsultativ për shërbime publike emergjencë. • Plani i punës së Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara. • Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2022.
SHKURT 2023	• Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2022. • Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2022. • Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual. • Raporti financiar për vitin 2022 i N.P.L "Pastrimi" sh.a. • Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

MARS 2023	• Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2022. • Raportet e punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2022. • Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2022. • Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.
PRILL 2023	• Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023. • Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit . • Informatë për ndarjen e bursave. • Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
MAJ 2023	• Rishikimi i buxhetit të komunës për vitin 2023. • Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit. • Shqyrtimi i Planit Zhvillimorë Komunal.
QERSHOR 2023	• Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026. • Miratimi i Planit Zhvillimorë Komunal. • Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2024.
KORRIK 2023	• Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2023. • Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2022. • Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2022. • Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2023. • Raporti për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2022. • Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2023 i N.P.L “Pastrimi” sh.a. • Informatë për sektorin e emergjencave.
GUSHT 2023	• Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2023. • Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023-2024. • Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2024. • Shqyrtimi i draft rregullores për Mirëmbajtje të Varrezave. • Informatë për korrije shirjet.
SHTATOR 2023	• Buxheti i komunës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2025-2026. • Miratimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2024. • Miratimi i rregullores për Mirëmbajtje të Varrezave. • Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2024. • Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024.
TETOR 2023	• Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023. • Miratimi i Hartës Zonale të Komunës së Hanit të Elezit • Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2024. • Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2024. • Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit . • Informatë e DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2022/2023 në SHFMU dhe SHML. • Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023 i N.P.L Pastrimi sh.a.

NËNTOR 2023	• Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi. • Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.
DHJETOR 2023	• Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023. • Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2023 • Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2023

- Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit gjatë vitit 2023, mund të mbajë edhe mbledhje tjera të rregullta më shumë se minimumi i paraparë me aktet në fuqi. Të gjitha mbledhjet e rregullta do të mbahen vetëm ditëve të punës.
- Të gjitha mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të jenë të hapura për qytetarë dhe përfaqësues të mediave publike. Nëse ndonjë mbledhje e rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës. Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarët e komunës dhe përfaqësues të mediave në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.
- Kuvendi i komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera, varësisht prej nevojave që paraqiten.
- Njoftimet për mbledhje të kuvendit të komunës bëhen publike. Materialet për mbledhjet e rregullta të kuvendit të komunës iu dorëzohen të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimet dhe materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Plani i mbledhjeve të kuvendit, i përcaktuar si në pikën tre (3) të këtij vendimi, është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime.
- Plani i mbledhjeve të kuvendit të komunës për vitin 2023, ka fuqi veprimi nga muaji Janar deri në muajin Dhjetorë të vitit 2023.
- Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 29.09.2022





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 8456/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 40.2, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit me numër 01/Nr.7703/2018 neni 79, 80, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.09.2022 merr:

VENDIM
PËR DRAFT RREGULLOREN PËR ADMINISTRIMIN E SHTËPISË SË KULTURËS
NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

1. Me këtë vendim aprovohet draft rregullorja për administrimin e Shtëpisë së Kulturës në Komunën e Hanit të Elezit.
2. Draft rregullorja për administrimin e Shtëpisë së Kulturës në Komunën Hanit të Elezit lëshohet në procedurë të diskutimit publik me qytetarët.
3. Obligohet Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport që t'i zhvilloj procedurat e diskutimit publik me qytetarët dhe ekzekutivin e komunës dhe pas kësaj rezultatet e diskutimit publik t'i paraqet në Kuvendin e Komunës për finalizimin e draft rregullorja për administrimin e Shtëpisë së Kulturës në Komunën Hanit të Elezit.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është draft rregullorja për administrimin e Shtëpisë së Kulturës në Komunën Hanit të Elezit.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet përkatëse),
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 29.09.2022

